



Formulari i Raportimit për iMonitor

Moduli i raportimit Monithon për monitorimin e kontratave publike

MONITORIMI I KONTRATAVE PUBLIKE

Monitorimi i një kontrate publike është një tjetër dimension i **monitorimit qytetar** që ju jep mundësinë të siguroheni që fondet e alokuara për komunitetin tuaj të shkojnë arrijnë në mënyrë efektive tek njerëzit që duhet të përfitojnë prej tyre.

Kontratat publike janë një pjesë kyçe përmes të cilave burimet publike transformohen në **mallra, shërbime ose infrastrukturë konkrete që ndikon drejtpërdrejt në jetën e qytetarëve**. Ato përcaktojnë kushtet me të cilat OFRUESIT e zgjedhur TË SHËRBIMEVE APO MALLRAVE, d.m. th. kompanitë që kontraktohen për ofrimin e tyre, i ofrojnë ato mallra, shërbime ose punime në kohën dhe vendin e duhur.

Në të njëjtën kohë, prokurimi publik është pjesa e administratës publike që preket lehtë nga **mungesa e efikasitetit dhe humbja e burimeve përmes korrupsionit dhe mashtrimit**, dhe kjo mund të ndodhë në mënyra të ndryshme. Për shembull, e mira është që ofruesit të zgjidhen përmes **konkurrencës** që agjencitë publike të kenë mundësi të japin kontrata në kushtet më të leverdishme ekonomike. Sidoqoftë, shpesh kontratat jepen në mënyra të tilla që u krijojnë mundësi disa personave të përfitojnë padrejtësisht. Për shembull, kështu mund të ndodhë nëse procesi i përzgjedhjes **bëhet qëllimisht më pak konkurruese që të përfitojë një furnitor i caktuar**, ndoshta një kompani e lidhur me zyrtarët publikë të përfshirë në procesin e përzgjedhjes. Gjithashtu, një furnitor mund ta marrë kontratën me një kosto më të lartë sesa është e nevojshme ose e justifikueshme. Në disa raste, problemet vërehen kur kontrata është në zbatim e sipër: kushtet e përcaktuara nga kontrata nuk plotësohen nga furnitori dhe ata që duhet të përfitojnë nga mallrat, shërbimet ose punimet e kontraktuara i marrin ato në sasi më të vogla ose me cilësi të rëndomtë, dhe në rastet më të rënda, mund të mos i marrin fare.

Monithon tashmë ju lejon të monitoroni edhe këtë aspekt të zbatimit të politikave publike.

Përmes iniciativës iMonitor, mund të aksesoni një seri modulesh trajnimi që ju ndihmojnë për të kuptuar aspektet themelore të prokurimit publik dhe mënyrat se si mund të manipulohet kundër interesit publik. Në këto module mund të mësoni se si t'i monitoroni në terren ato kontrata që vendosni të monitoroni, si të mblidhni prova nëse një kontratë po zbatohet apo jo si duhet dhe si t'i raportoni problemet e identifikuara tek autoritetet e duhura duke përdorur këtë

mjet raportimi. Kjo mund t'ju ndihmojë t'i **identifikoni problemet në kohën që mundet ende të zgjidhen**, duke marrë masat që mallrat, shërbimet dhe punimet e kontraktuara t'u sigurohen qytetarëve siç ishin kontraktuar.

Formulari i raportimit përbëhet nga tre pjesë, duke ndjekur një strukturë të ngjashme me raportin për monitorimin e projekteve, ku do të bëni secili pjesën që ju takon:

Hapi 1 - Analiza mbi bazë dokumentacioni (Desk analysis)

Hapi 2 - Zbatimi i Kontratës

Hapi 3 - Rezultatet dhe ndikimi i projektit

Për secilën pjesë keni edhe udhëzime shtesë se çfarë informacionesh mund të mblidhen, ku dhe si t'i mblidhni ato, si dhe çfarë është më e rëndësishme për to dhe ku duhet të keni kujdes.

Të gjitha fushat mund të plotësohen automatikisht, por për shkak të URL-së Opentender, disa mund t'ju dalin të plotësuara paraprakisht. Gjithmonë kontrolloni që informacioni të jetë i saktë!

*Pyetësi mbulon shumë aspekte të monitorimit të një kontrate, **por të gjitha pyetjet janë fakultative dhe përgjigjet mund të ndryshohen para se raporti të dërgohet.** Sa më shumë informacion të grumbulloni, aq më mirë! Për hartimin e raportit, mund të gjeni këshilla praktike në [manualin tonë iMonitor: Monitorimi i Kontratave Publike](#)*

URL e kontratës së zgjedhur Nga Opentender:

Pasi të futni URL-në e kontratës së përzgjedhur nga Opentender, disa seksione mund të plotësohen automatikisht përmes importimit të të dhënave. Megjithatë, në databazën e tyre mund të mos jenë të gjitha informacionet që ju duhen. Gjithmonë kontrolloni dy herë nëse të dhënat janë importuar vetë dhe nëse jo, duhet t'i kërkonti manualisht.

[IMPORTO TË DHËNAT

Titulli i Raportit

Autori i raportit

Këtu vendosni emrin e organizatës ose ekipit tuaj të monitorimit. Nëse nuk doni ta bëni publik emrin, mund të shkruani "ekipi iMonitor".

Këto tre seksione (URL-ja, Titulli dhe Autori) vazhdojnë të jenë të dukshme gjatë gjithë procesit të ësimit të formularit

HAPI 1 - ANALIZA MBI BAZWN E DOKUMENTACIONIT (DESK ANALYSIS)

MONITUTOR - HAPI 1

Në thelb, monitorimi i **zbatimit të një kontrate** përfshin verifikimin nëse ajo që parashikohet në letër, d.m. th. në kontratë, po ndodh vërtet në realitet, aty ku po zbatohet kontrata.

Për të vlerësuar këtë, nevojiten disa informacione bazë nga vetë kontrata dhe dokumente të tjera që lidhen me të. Dokumentet kryesore mund të përfshijnë:

- **kontratën;**
- **zgjatjet dhe modifikimet e kontratës** (nëse ka);
- **raportet për zbatimin e kontratës;**
- **urdhër pagesat dhe faturat;**
- për projektet e ndërtimit, **dokumentet teknike** (p. sh. projektet, specifikimet e materialeve të përdorura), dhe **raportet e ecurisë së projekteve.**

Të dobishme mund të jenë edhe informacionet relevante lidhur me procesin e dhënies së kontratës për të parë se si është zgjedhur kompania që i është dhënë kontrata. Për këtë, një tjetër dokument që mund të merret është **raporti i vlerësimit të ofertave** lëshuar nga komisioni i vlerësimit të ofertave.

Këto mund të aksesohen përmes platformave online me të dhëna të prokurimit publik, ose të kërkohen përmes një kërkesë për informim publik drejtuar agjencisë kontraktuese ose autoritetit përgjegjës për prokurimin publik.

Të dobishme mund të jenë edhe informacione të tjera shtesë. Për shembull, mund të bëni një kërkim në internet duke përdorur disa nga fjalët kyçe marrë nga përshkrimi i kontratës (p.sh. ndërtimi i një shkolle në rrethin XYZ) dhe blerësit (p. sh. Bashkia XYZ) për të gjetur informacione që lidhen me kontratën ose projektin përkatës që na ndihmon të kuptojmë më mirë kontekstin e një kontrate specifike dhe me çfarë politike lidhet ajo. Kjo mund të raportohet në **Seksionin A: Informacion mbi Projektin/Programin**. Në këtë seksion, ekziston edhe një tregues nëse kontrata lidhet me ndonjë projekt të financuar nga BE-ja dhe ku mund të gjeni informacion në lidhje me të.

Në **Seksionin B: Informacion mbi Kontratën**, nëse në fushën përkatëse të platformës opentender.eu fusni linkun e kontratës së përzgjedhur, importohen automatikisht të dhënat bazë për kontratën, duke përfshirë edhe profilin e integritetit të kontratës. Atë informacion mund ta ndryshoni ose në vend të tij të vendosni detajet e kontratës të marra përmes dokumentacionit

të mbledhur ose të dhënave zyrtare. Këto të dhëna na ofrojnë një pasqyrë që tregon se çfarë duhet të dorëzojë kompania e kontraktuar, kur dhe me çfarë kostoje, si dhe disa prej kushteve kryesore për realizimin e kontratës, si dhe nëse ka pasur ndryshime të atyre kushteve, gjë që ndonjëherë mund të jetë tregues i ndonjë manipulimi.

Në fund, nëse doni t'i hyni pak më thellë, mund të bëni edhe disa kërkime mbi kompaninë e kontraktuar dhe informacionin e gjetur ta shtoni në **Seksionin C: informacion mbi kompaninë e kontraktuar**. Këtu hyn informacioni i kontaktit dhe regjistrimit të kompanisë së kontraktuar, si dhe informacione të tjera të rëndësishme që mund të gjeni e që mund të jenë tregues të tjera rrezeve për korrupsion në mënyrën se si është dhënë kontrata. Nëse në kontratë ka nënkontraktorë të specifikuar, mund të kërkoni për të njëjtin informacion edhe mbi këta nënkontraktorë dhe ta përfshini atë informacion në raport.

Seksioni A: Informacioni mbi Projektin/Programin

A ka lidhje kjo kontratë me ndonjë projekt të financuar nga BE-ja?

[importohet automatikisht nga opentender.eu] PO/JO

[Nëse po, shfaqet kjo pyetje, pastaj sa vijon:]

URL-ja e projektit

Nëse keni identifikuar një projekt të financuar nga BE-ja me të cilin lidhet kjo kontratë, mund ta vendosni URL-në përkatëse këtu. Informacione të përgjithshme mbi projekte relevante të financuara nga BE-ja mund të gjenden në portalin [EU Regional Policy](#), kurse informacione më të hollësishme mbi projektin i gjeni edhe në portalin [Portali Kohesio](#) dhe në [projektet e financuara nga Recovery and Resilience Facility](#).

[Nëse jo, shkojmë direkt tek pyetjet e mëposhtme:]
Shuma totale e financimit që është marrë për këtë projekt

Fusha kryesore që mbulon projekti

[menuja ku mund të përzgjidhni fushën: Transporti, Mjedisi, Arsimi, Inovacioni, Kultura dhe Turizmi, Shëndetësia, Energjia, Rigjenerimi Urban dhe Rural, Konkurrenca mes Sipërmarrjeve, Punësimi dhe Puna, Rendi Publik dhe Siguria]

Programi i politikave

Nëse keni identifikuar një program politikash me të cilin lidhet kontrata që po monitoroni, mund ta përmendni këtu. Lidhur me këtë mund ta gjeni informacionin vetë duke parë kontratën, duke kërkuar online në lidhje me objektin e kontratës ose kur intervistoni përfaqësues nga agjencia kontraktuese. Nëse mundeni, vendoseni linkun që të çon tek informacioni mbi programin e politikave që keni gjetur.

Seksioni B: Informacion mbi kontratën

MONITUTOR

Në këtë seksion, disa fusha importohen automatikisht nga të dhënat që gjenden për këtë kontratë në opentender.eu. Në të gjendet edhe profili i integritetit për secilin tender dhe për secilën kontratë, bazuar në flamujt e kuq të përzgjedhur si tregues të korrupsionit në prokurim. Nëse niveli i integritetit të prokurimit rezulton i ulët, do të thotë ka shumë rrezik që në atë proces prokurimi të ketë pasur korrupsion.

Nëse nuk e keni zgjedhur kontratën direkt në opentender.eu, mund ta fusni informacionin duke vendosur në krye linkun korrespondues opentender.eu. Mund ta plotësoni me informacione nga burime të tjera (p.sh. nga portali kombëtar i prokurimit, me një kopje të kontratës). Nëse konstatoni mospërputhje midis informacionit që merrni nga të dhënat nga opentender.eu dhe nga kontrata origjinale, mund të korrigjoni informacionin në fushën përkatëse. Në atë rast, sigurohuni që të bashkëngjitni dokumentacionin përkatës ku i bazoni korrigjimet e bëra.

Opentender.eu source

[linku i faqes opentender.eu]

Titulli i kontratës

[importohet automatikisht nga opentender.eu]

Objekti i kontratës: Cili është saktësisht produkti që po monitoroni? (vendosni kodin CPV që është kodi i Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit - Common Procurement Vocabulary - dhe përshkrimin)

[importohet automatikisht nga opentender.eu]

Autoriteti kontraktues: Cila agjenci e ka dhënë kontratën?

[importohet automatikisht nga opentender.eu]

Kompania e kontraktuar: Cilës kompani i është dhënë kontrata?

[importohet automatikisht nga opentender.eu]

Vlera e kontratës: Sa është vlera totale e kontratës, siç përcaktohet në kontratën origjinale?

Nëse çmimi përfundimtar që importohet nga opentender.eu nuk korrespondon me vlerën e kontratës siç përcaktohet në kontratë, vendosni këtu vlerën e përcaktuar në kontratën zyrtare të firmosur.

[importohet automatikisht nga opentender.eu]

Profili i integritetit të kontratës (opentender.eu - Rezultati i përgjithshëm gjenerohet automatikisht)

<i>Treguesi</i>	<i>Vlerësimi (Score)</i>	<i>Vlera bruto (raw value)</i>
Integriteti		
Numri i ofertuesit		
Njoftimi për tender		
Lloji i Procedurës		
Periudha e publikimit të njoftimit		
Kohëzgjatja e periudhës së vendimit		
Parajsë fiskale		
Ligji i Benfordit		
Pjesa që zë kontrata e kompanisë së kontraktuar në raport me shpenzimet e autoritetit kontraktues për prokurime publike		

Tregjet e ndara		
-----------------	--	--

Çfarë lloj kontrate po monitoroni?

Kjo pyetje ka të bëjë me kategorinë primare të kontratës publike që po monitoroni. Kontratat publike në përgjithësi mund të klasifikohen në tre lloje kryesore: furnizime (mallra), shërbime dhe punime.

- *Furnizime: Kontrata që lidhen me blerjen e sendeve fizike, si pajisje zyre, automjete ose pajisje mjekësore. Për shembull, nëse bëhet fjalë për blerje mobiljesh për zyra nga bashkia, kontrata përkatëse i përket kategorisë së "furnizimit".*
- *Shërbimet: Kontrata për shërbime të ndryshme, si shërbime projektimi inxhinierik, mbikëqyrje dhe auditim të procesit të menaxhimit të mbetjeve, si dhe vlerësim të ndikimit në mjedis.*
- *Punimet: Këto kontrata përfshijnë projektet e ndërtimit ose infrastrukturës, duke përfshirë rrugët, urat ndërtesa publike dhe ndërmarrjet e ujësjellës-kanalizimeve. Për shembull, nëse bashkia po ndërton një park të ri apo po rinovon një shkollë, kjo kontratë futet tek kategoria e "punimeve".*

[importohet automatikisht nga opentender.eu]

[Në rast se është zgjedhur opsioni "Punime", shfaqet kjo pjesë shtesë e Monitutor-it:]

MONITUTOR

Edicioni i ri i projektit **iMonitor** synon të trajtojë fushat me rrezik të lartë, si projektet e ndërtimit, me qëllim rritjen e mbikëqyrjes në përputhje me prioritetet politike në nivel të Bashkimit Europian. Meqenëse keni zgjedhur një projekt në këtë fushë, në këtë pyetësor do të gjeni pyetje dhe udhëzime shtesë, si edhe në materialet trajnuese që ju janë ofruar në fazat e mëparshme të projektit.

Data e firmosjes: Kur është firmosur kontrata zyrtarisht?

[data]

Data e fillimit: Cila është data e fillimit të periudhës së kontratës, siç përcaktohet në kontratën e firmosur zyrtare?

[data]

Data e përfundimit: cila është data e përfundimit të periudhës së kontratës, siç përcaktohet në kontratën e firmosur zyrtare?

Ju lutemi, specifikojeni këtu datën siç është në kontratën e firmosur. Çdo ndryshim i kësaj date në kontratën e firmosur duhet të raportohet në Hapin 2-Zbatimi i Kontratës

[data]

Vendi i zbatimit/dorëzimit: Ku do të dorëzohen mallrat e blera/shërbimet e kontraktuara/punimet

e kontraktuara?

Këtu mund të vendosni adresën e vendit të zbatimit të kontratës/dorëzimit të mallrave apo punimeve siç përcaktohet në kontratë. Nëse ka më shumë se një vend, ju lutemi përdorni butonin më poshtë "Shto Vende të tjera të Zbatimit të Kontratës/Dorëzimit të Mallrave".

+ Shto një tjetër vend Zbatimi/Dorëzimi

[APLIKIMI I HARTËS PËR VIZUALIZIM]

Afati i Zbatimit/Dorëzimit: Nëse ky informacion gjendet në kontratë, kur duhet të dorëzohen mallrat e blera/shërbimet e kontraktuara? / Cila është data e planifikuar e përfundimit të punimeve të kontraktuara, nëse specifikohet në kontratë?

Mbikëqyrësi i kontratës: Si quhet personi i caktuar nga autoriteti kontraktues për të mbikëqyruar kontratën dhe zbatimin e saj?

Mbikëqyrësi i kontratës është personi përgjegjës për mbikëqyrjen dhe garantimin e ekzekutimit të duhur të kontratës për autoritetin kontraktues. Roli i tyre është vendimtar në prokurimin publik për të garantuar që puna ose shërbimet e kontraktuara të përmbushin standardet e specifikuara. Mbikëqyrësi i kontratës është përgjegjës për:

- Ecurinë e monitorimit: Ata ndjekin ecurinë e projektit për t'u siguruar që projekti po ecën sipas afateve dhe buxhetit të miratuar.
- Sigurimi i cilësisë: Ata sigurohen që mallrat, punimet ose shërbimet e realizuara të plotësojnë standardet e kërkuara të cilësisë dhe performancës.
- Përputhshmëria: Mbikëqyrësi merr masa që kontraktuesi të veprojë në përputhje me të gjitha termat dhe kushtet e specifikuara në kontratë, duke përfshirë edhe rregulloret ligjore dhe mjedisore.

Mbikëqyrja e kontratës është thelbësore në prokurimet publike pasi ndihmon në parandalimin e problemeve si tejkalimet e kostove, vonesat dhe punimet që nuk plotësojnë standardet e kërkuara. Ai gjithashtu siguron transparencën dhe llogaridhënien, pasi mbikëqyrësi vepron si monitorues (watchdog) në emër të publikut. Për shembull, nëse bashkia punëson një kompani ndërtimi për të ndërtuar një shkollë të re, mbikëqyrësi i kontratës merr masa që kompania e kontraktuar të plotësojë kushtet e kontratës dhe ta përfundojë projektin në kohë duke respektuar standardet e sigurisë dhe cilësisë.

Nënkontraktimi: A parashikon kontrata se do të ketë kompani të tjera që do të ofrojnë një pjesë të shërbimeve/punëve të kontraktuara?

Nënkontraktim do të thotë që në kontratë parashikohet që një pjesë e punimeve i delegohet një kompanie ose një individ tjetër. Kjo mund të bëhet për arsye të ndryshme, si për shembull për realizimin e detyrave të specializuara ose arritja e leverdishmërisë ekonomike. Për shembull, në një projekt të madh infrastrukturor, kontraktuesi kryesor mund të punësojë një kompani të specializuar elektrike për realizimin e instalimeve elektrike ndërkohë që kompania e kontraktuar direkt përqendrohet në punën kryesore të ndërtimit. Kjo mund të ulë kostot dhe të rrisë efikasitetin e projektit. Megjithëse nënkontraktimi mund të jetë i dobishëm, ai mund të sjellë edhe kompleksitete dhe rreziqe, ndoshta edhe korrupsion. Në disa raste, kontrata mund t'i jepet një kompanie që ekziston vetëm në letra (në anglisht: fake supplier) (p.sh. një kompani guackë - në anglisht: shell company - e lidhur me një zyrtar publik ose me një politikan) dhe kjo kompani, për të bërë punën nënkontraktin një kompani tjetër. Kështu, një pjesë e vlerës së kontratës i mbetet zyrtarit apo politikanit. Në raste të tjera, mund të jetë nënkontraktori ai që mund të jetë një kompani që ekziston vetëm në letra dhe që përdoret vetëm për t'i kaluar pagesën për shërbime që nuk ofrohen fare. Monitorimi i nënkontraktimit është thelbësor për t'u siguruar që shërbimet e nënkontraktuara vërtet ofrohen dhe plotësojnë standardet e specifikuara në kontratën kryesore.

Po

Jo

Nëse nuk mund të përgjigjeni po ose jo, ju lutemi jepni një shpjegim

Ju lutemi, vendosni informacione më të hollësishme në fushën më poshtë. Nëse u përgjigjët "Jo", përshkruani problemet e zbuluara. Nëse nuk mund të përgjigjeni "Po" ose "Jo", ju lutemi jepni një shpjegim Jepni shpjegime sa më faktike dhe sa më të sakta.

[Nëse po, del një tjetër grup pyetjesh, deri tek "Ndryshimet e kontratës"]

Kush është/Kush janë nënkontraktorët?

Mund të shtoni këtu emrin e nënkontraktorit(ve) dhe vlerën përkatëse të shërbimeve/punëve që do të ofrohen prej tyre. Nëse ka më shumë se një nënkontraktor, mund të përdorni opsionin "Shto nënkontraktorë të tjerë" më poshtë.

Emri i nënkontraktorit	Vlera e nënkontraktimit

+ Shto një nënkontraktor tjetër

\ janë të gjithë nënkontraktorët të përcaktuar me emër në kontratë (ose në njoftimin zyrtar) **para fillimit të zbatimit?**

Po

Jo

Nëse nuk mund të përgjigjeni po ose jo, ju lutemi jepni një shpjegim

Ju lutemi, vendosni informacione më të hollësishme në fushën më poshtë. Nëse u përgjigjët "Jo", përshkruani problemet e zbuluara. Nëse nuk mund të përgjigjeni "Po" ose "Jo", ju lutemi jepni një shpjegim Jepni shpjegime sa më faktike dhe sa më të sakta.

Vlera totale e shërbimeve të nënkontraktuara: Sa është vlera totale e shërbimeve/punimeve që do të ofrohen nga kompani të tjera, sipas kontratës?

[Ilogaritet automatikisht nga fushat e mëparshme]

% e shërbimeve të nënkontraktuara

Kjo tregon se sa prej punimeve ose shërbimeve të parashikuara në një kontratë qeveritare i jepen kompanive të tjera, në raport me vlerën totale të kontratës. Na ndihmon të kuptojmë se ç'pjesë zë nënkontraktimi dhe si po si ndikon ai te projekti. Legjislacioni i prokurimit shpesh vendos kufizime në lidhje me sasinë e punës së parashikuar në kontratat publike që mund të nënkontraktohen nga kompani të tjera. Për shembull, në një juridiksion të caktuar ligji mund të thotë se mund të nënkontraktohet jo më shumë se 30% e vlerës së kontratës. Këto rregulla vendosen për të mos u mbështetur tek kompanitë e tjera në shkallë të tepruar dhe për t'u siguruar që kompania kryesore që kontraktohet për një punë apo shërbim të caktuar luan rolin kryesor në zbatimin e kontratës.

[Ilogaritet automatikisht nga fushat e mëparshme]

ka zbatues të vërejtur në terren / në produktet e dorëzuara që **nuk janë të listuar si furnitorë ose nënkontraktorë?**

Po

Jo

Nëse nuk mund të përgjigjeni po ose jo, ju lutemi jepni një shpjegim

Ju lutemi, vendosni informacione më të hollësishme në fushën më poshtë. Nëse u përgjigjët "Jo", përshkruani problemet e zbuluara. Nëse nuk mund të përgjigjeni "Po" ose "Jo", ju lutemi jepni një shpjegim Jepni shpjegime sa më faktike dhe sa më të sakta.

[Nëse po, del një tjetër grup pyetjesh:]

Emri(at) / kompania(të):	
Ku u vërejt / u vërejtën (vendndodhja e punimeve ose referenca e produktit të dorëzuar):	
Data / ora e vëzhgimit:	
Përshkrimi i provave (logo/shenja, shënime në mjete, lista e stafit, metadata, nënshkrime, etj.):	
<i>Mund të shtoni çdo skedar/foto/dokument të rëndësishëm për të dokumentuar këtë gjetje në seksionin “Ngarkimi i dokumenteve”.</i>	

Ndryshimet e kontratës: A është ndryshuar apo zgjatur kontrata?

Ndryshimet e kontratës sjellin ndryshime në afatet dhe kushtet fillestare të kontratës dhe mund të përfshijnë ndryshime në objektin e projektit, ndryshime në buxhet, afate kohore dhe elementë të tjerë thelbësorë. Ato ndryshime duhet të jenë në përputhje me kushtet që parashikon kontrata fillestare për ndryshimet në të, si dhe me kufizimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi të prokurimit publik (legjislacioni kombëtar dhe ai i BE-së). Gjithashtu, në rastin e ndryshimeve të kontratës, këto ndryshime duhet të njoftohen publikisht.

Këto ndryshime zakonisht bëhen për t'iu përshtatur situatave të papritura, ndryshimit të nevojave të projektit ose për të korigjuar gabime ose mangësi në kontratën fillestare. Për shembull, ndryshime mund të bëhen për të zgjatur kohëzgjatjen e kontratës përtej datës së përfundimit të caktuar fillimisht, për shkaqe si vonesat e projektit, kërkesat shtesë të punës ose nevoja për më shumë kohë për përfundimin e projektit, si dhe për të ndryshuar vlerën e kontratës brenda kufijve të përcaktuara me ligj.

Nëse ndryshimet bëhen pa transparencë dhe mbikëqyrje, ka rrezik që të bëhet korrupsion. Ato mund të shfrytëzohen për të manipuluar kushtet e kontratës dhe për të fryrë artificialisht kostot, duke rezultuar në keqpërdorim të fondeve publike. Prandaj, është e rëndësishme që këto aspekte të kontratave të monitorohen nga afër, sepse mund të ndikojnë ndjeshëm në përdorimin e fondeve publike dhe në rezultatet e projekteve në tërësi. Gjithashtu, është thelbësore që këto ndryshime të jenë të bazuara, brenda kufijve ligjorë dhe në të mirë të interesit publik.

Është gjithashtu e rëndësishme të theksohet se këto ndryshime nuk duhet të ndryshojnë kërkesat mjedisore të përcaktuara në lejen e zhvillimit ose vendimin mjedisor (nëse një vendim i tillë është lëshuar), veçanërisht kur projekti ka qenë subjekt i një procedure të Vlerësimit të Ndikimit në

Mjedis (VNM / EIA). Kushtet mjedisore mund të lidhen, për shembull, me metodat e kryerjes së punimeve të ndërtimit, menaxhimin e ujit, mbrojtjen e florës dhe faunës, masat e kompensimit mjedisor, ose kërkesa shtesë për monitorim.

Një pyetje e dobishme për të vlerësuar shkallën e këtij ndryshimi është: Sa ndryshime rezultuan nga rrethanat që një autoritet kontraktor i kujdesshëm nuk mund t'i kishte parashikuar, dhe/ose nga punime, shërbime ose furnizime shtesë nga kontraktori origjinal që u bënë të nevojshme por nuk ishin përfshirë në prokurimin fillestar?

Po

Jo

Nëse nuk mund të përgjigjeni po ose jo, ju lutemi jepni një shpjegim

Ju lutemi, vendosni informacione më të hollësishme në fushën më poshtë. Nëse u përgjigjët "Jo", përshkruani problemet e zbuluara. Nëse nuk mund të përgjigjeni "Po" ose "Jo", ju lutemi jepni një shpjegim Jepni shpjegime sa më faktike dhe sa më të sakta.

[Nëse po, shfaqet një grup tjetër pyetjesh]

A janë ndryshimet e publikuara dhe të nënshkruara?

Po

Jo

Nëse nuk mund të përgjigjeni po ose jo, ju lutemi jepni një shpjegim

Ju lutemi, vendosni informacione më të hollësishme në fushën më poshtë. Nëse u përgjigjët "Jo", përshkruani problemet e zbuluara. Nëse nuk mund të përgjigjeni "Po" ose "Jo", ju lutemi jepni një shpjegim Jepni shpjegime sa më faktike dhe sa më të sakta.

Çfarë ndryshojnë modifikimet e bëra?

Rritje e vlerës

Zgjatje e afatit

- Ndryshimi i fushës së punës/shërbimeve
 Tjetër:

Data e përfundimit të kontratës pas ndryshimeve të bëra:

Fushën përkatëse mund ta plotësoni në varësi të mënyrës se si përcaktohet zgjatja e afatit në ndryshimet e bëra në kontratë. Në disa kontrata mund të vendoset një datë e re për përfundimin e kontratës, tek disa të tjera mund të thuhet se afati i zbatimit shtyhet për një periudhë të caktuar (p.sh. 90 ditë).

Cila është data e re e përfundimit të periudhës së kontratës, siç përcaktohet në ndryshimin e fundit të kontratës?

Sa ditë është zgjatur periudha fillestare e kontratës me ndryshimet e bëra?

rritja e kohëzgjatjes së kontratës në %

[Ilogaritet automatikisht nga fushat e mëparshme]

A ekziston një arsytim i shkruar që citon bazën ligjore ose rrethanat e paparashikueshme?

Po

Jo

Nëse nuk mund të përgjigjeni po ose jo, ju lutemi jepni një shpjegim

Ju lutemi, vendosni informacione më të hollësishme në fushën më poshtë. Nëse u përgjigjët "Jo", përshkruani problemet e zbuluara. Nëse nuk mund të përgjigjeni "Po" ose "Jo", ju lutemi jepni një shpjegim Jepni shpjegime sa më faktike dhe sa më të sakta.

Vlera e re e kontratës

Fushën përkatëse mund ta plotësoni në varësi të mënyrës se si përcaktohet zgjatja e afatit në ndryshimet e bëra në kontratë. Në disa kontrata mund të vendoset një vlerë e re totale e kontratës, në disa të tjera mund të përcaktohet shuma me të cilën rritet vlera e kontratës (p.sh. një rritje prej 30 250 EUR).

Cila është vlera e re totale e kontratës, siç përcaktohet në ndryshimin e fundit të kontratës?

Sa është rritja e vlerës totale fillestare të kontratës me ndryshimet e bëra?

rritja e vlerës së kontratës në %

[Ilogaritet automatikisht nga fushat e mëparshme]

Data e përfundimit të kontratës pas ndryshimeve të bëra:

Fushën përkatëse mund ta plotësoni në varësi të mënyrës se si përcaktohet zgjatja e afatit në ndryshimet e bëra në kontratë. Në disa kontrata mund të vendoset një datë e re për përfundimin e kontratës, tek disa të tjera mund të thuhet se afati i zbatimit shtyhet për një periudhë të caktuar (p.sh. 90 ditë).

Cila është data e re e përfundimit të periudhës së kontratës, siç përcaktohet në ndryshimin e fundit të kontratës?

Sa ditë është zgjatur periudha fillestare e kontratës me ndryshimet e bëra?

rritja e kohëzgjatjes së kontratës në %

[Ilogaritet automatikisht nga fushat e mëparshme]

Seksioni C: Informacioni për kompaninë e kontraktuar

Në kontratat që përfshijnë më shumë se një kompani (kompani që kanë paraqitur oferta, por që nuk u është dhënë kontrata), është e rëndësishme të identifikohen lidhjet e mundshme midis kompanisë fituese dhe këtyre kompanive të tjera, në mënyrë që të vlerësohet nëse ka pasur vërtet konkurrencë gjatë procesit të prokurimit publik. Këtu përfshihen hulumtimet dhe analizimi i të dhënave për të gjitha kompanitë ofertuese që kanë marrë pjesë në procesin e prokurimit, por që nuk janë shpallur fituese.

Informacion mbi kompaninë

Bazuar në të dhënat e vendndodhjes së kompanisë, mund të verifikoni edhe imazhet e adresës së saj duke përdorur Google Street View, nëse në të ka imazhe të vendndodhjes. Mund të bëni edhe një kërkim bazë në internet me emrin e kompanisë për të parë se çfarë informacionesh të tjera mund të gjendet.

Emri	[importohet automatikisht nga opentender.eu]
Adresa	[importohet automatikisht nga opentender.eu]

Kodi postar	[importohet automatikisht nga opentender.eu]
Qyteti	[importohet automatikisht nga opentender.eu]
Kodi NUTS (Nomenclature of Territorial Units for Statistics - Nomenklatura e Njësive Territoriale për Statistika)	[importohet automatikisht nga opentender.eu]
Vendi/Shteti	[importohet automatikisht nga opentender.eu]

Informacioni i kontaktit

Numri i tefoni t	
Email	
Website	
Tjetër	

Informacioni i regjistrimit

Informacioni i regjistrimit për kompanitë zakonisht mund të merret nga burime publike, si agjencitë qeveritare përgjegjëse për regjistrimin e kompanive të biznesit. Në shumë vende, ky informacion gjendet në platforma të dedikuara online ose në regjistrat e biznesit, dhomat e tregtisë ose ofrues privatë. Megjithatë, mund të ketë edhe disa kufizime:

- *Informacionet personale të pronarëve të ndërmarrjeve ose aksionerëve mund të jenë të kufizuara për shkak të rregulloreve për mbrojtjen e të dhënave;*
- *Për të aksesuar dokumente të caktuara ose për të bërë kërkime për kompanitë mund të aplikohen tarifa;*
- *Për të parandaluar keqpërdorimin ose aksesin e paautorizuar në këto informacione mund të ketë masa sigurie, si për shembull mund t'ju duhet të regjistroheni, të vërtetoni identitetin tuaj ose të kaloni ndonjë test të vogël sigurie (captchas - p.sh. të klikosh mbi imazhe ose të shkruash diçka për të provuar se nuk je robot).*

Në shkallë evropiane, ka një [motor kërkimi të centralizuar](#) që merr informacione nga regjistrat kombëtarë të vendeve anëtare. Të dhënat nga juridiksionet e tjera mund të merren nga [opencorporates.com](#).

Numri i identitetit (ID) të kompanisë	
Lloji i ID-së	[ID nga regjistri i kompanive, NIPT]

Aktivitetet (dhe kodet) e biznesit	
<p><i>Aktivitetet e biznesit dhe kodet e tyre, të njohura shpesh si kodet e klasifikimit të industrive, na japin përshkrime numerike të standardizuara të aktiviteteve ekonomike të një kompanie. Në Evropë, përdoret sistemi NACE (Nomenklatura e Aktiviteteve Ekonomike). Këto kode janë të strukturuar në mënyrë hierarkike, ku secili nivel kodit ofron informacion më të detajuar në lidhje me aktivitetet kryesore të kompanisë. Shifrat e para të kodit tregojnë sektorin e industrisë ku operon kompania, ndërsa shifrat e tjera tregojnë nënsektorët ose specializimet.</i></p> <p><i>Kur kompanive iu jepen kontrata qeveritare, zyrtarët duhet të sigurohen që ato kontrata t'u jepen kompanive me përvojë dhe ekspertizën përkatëse në industrinë ose sektorin ku zhvillohet tenderi. Nëse kodi i deklaruar i aktivitetit të biznesit të një kompanie nuk përputhet me natyrën e kontratës që i është dhënë, mund të ngrihen dyshime. Për shembull, nëse një kompani e klasifikuar kryesisht si kompani që operon në fushën e "Bujqësisë" merr një kontratë në fushën e "Shërbimeve të Teknologjisë së Informacionit" pa një shpjegim të qartë, mund të bëhen hetime të mëtejshme, pasi ky mund të jetë tregues i parregullsive në procesin e prokurimit. Përveç kësaj, kompanitë që rezultojnë me aktivitet të regjistruar në disa fusha që nuk kanë lidhje me njëra-tjetrën mund të përbëjnë profile të pazakonta të ofruesve të shërbimeve apo punimeve.</i></p> <p><i>Është e rëndësishme të theksohet se kodet e aktivitetit të biznesit nuk korrespondojnë me kodet CPV (kodet e Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit) që përdoren për të përshkruar natyrën e mallrave, punëve ose shërbimeve që prokurohen.</i></p>	

Data e themelimit	
<p><i>Ofruesit e rinj të shërbimeve/punimeve (p.sh. një kompani e themeluar më pak se 12 muaj para se të shpallet fituese e një tenderi) mund të tregojë një profil të rrezikshëm.</i></p>	
Përfaqësuesi ligjor - emri dhe ID-ja	
Aksioneri (aksionerët) - emri dhe ID-ja/ID-të e tyre	
Individë të tjerë që lidhen me të - emri dhe ID-ja	

+ Shto kompani tjetër (p. sh. një nënkontraktor)

Informacione të tjera të rëndësishme

MONITUTOR:

Këtu mund të raportoni çdo informacion tjetër që mund të jetë tregues i një rreziku të lartë korrupsioni ose parregullsish lidhur me kompaninë e kontraktuar. Disa nga pyetjet që mund të keni parasysh janë:

1. Mos ndoshta nuk kemi mjaftueshëm indicie që tregojnë se kjo kompani përfaqëson një biznes të ligjshëm dhe të konsoliduar (p. sh. kompania nuk ka një faqe interneti dhe nuk është e pranishme në platforma në internet që promovojnë biznesin e saj; në fotot e zyrave të saj nuk ka asnjë tregues të aktiviteteve që deklarohet se ushtron; në internet nuk gjendet asnjë informacion tjetër për këtë kompani)?
2. A keni identifikuar ndonjë lidhje midis individëve që kanë lidhje me kompaninë e kontraktuar dhe me autoritetin kontraktues? Mund të bëni kërkime në internet me emrat e tyre dhe të shihni nëse ndonjë prej tyre është zyrtar publik që ka lidhje me autoritetin kontraktues që ka kontraktuar kompaninë, gjë që mund të tregojë një konflikt të mundshëm interesi.
3. A keni identifikuar ndonjë lidhje midis kompanisë së kontraktuar dhe ndonjë figure politike? Mund të shihni nëse, sipas kërkimeve në internet, individët e lidhur me kompaninë janë ose kanë qenë zyrtarë të zgjedhur ose nëse kanë lidhje ose njohje me politikanë të caktuar.
4. A keni identifikuar ndonjë lidhje midis kompanisë së shpallur fituese dhe kompanive të tjera? Mund të shihni, për shembull, nëse përfaqësuesit, menaxherët ose aksionerët e kompanisë së shpallur fituese rezultojnë të regjistruar edhe në lidhje me kompani të tjera. Mundet, gjithashtu, të kontrolloni edhe nëse ka kompani të tjera me të njëjtën adresë ose informacion kontakti si kompania fituese (me të njëjtin numër telefoni, adresë e-maili).
5. Nëse po monitoroni një kontratë punimesh dhe keni pasur akses në dokumentacionin teknik të projektit, mund të verifikoni nëse ka ndonjë lidhje të dukshme e të drejtpërdrejtë midis kompanisë së kontraktuar dhe kompanisë/profesionistëve përgjegjës për përgatitjen e atij dokumentacioni, që mund të jetë tregues i aksesit në informacion të privilegjuara.
6. A mund të gjeni informacione nëse kjo kompani është dënuar/gjobitur më parë për mosrealizim si duhet të kontratave të tjera publike? Mund të kontrolloni informacionin mbi kompanitë që ndodhen në lista të zeza, të cilat shpesh publikohen në portalet e prokurimit publik ose ju jepen nëse bëni, për shembull, një kërkesë për informacion drejtuar autoritetit të prokurimit publik.

- Ruaj

HAPI 2 - ZBATIMI I KONTRATËS

MONITUTOR:

Tani që ju dhe ekipi juaj i keni bërë detyrat e shtëpisë dhe keni mbledhur informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për kontekstin e kontratës, i erdhi radha monitorimit të zbatimit konkret të kontratës. Në përgjithësi, e mira është që kjo të bëhet duke vizituar faqen ku publikohen aktivitetet e zbatimit të kontratës, ose disa faqe të përzgjedhura, nëse ka më shumë se një faqe. Aty mund të verifikoni konkretisht nëse mallrat, shërbimet apo punimet e kontraktuara po ofrohen ose janë ofruar në përputhje me kushtet e kontratës. Për udhëzime praktike se si të planifikoni dhe organizoni këtë pjesë të punës së monitorimit, çfarë të kërkoni dhe si të dokumentoni provat e mbledhura për raportim më vonë, mund t'i referoheni [Manualit të Monitorimit të Kontratave Publike](#).

Edhe nëse nuk keni mundësi të inspektoni vendin e zbatimit të kontratës, përpiquni të bëni një vlerësim bazuar në dokumentacionin e marrë gjatë analizës së dokumentacionit të mbledhur. Gjithashtu, mund të mblidhni informacion duke intervistuar persona përkatës, si një përfaqësues të autoritetit kontraktues, në veçanti mbikëqyrësin e caktuar të kontratës, ose një përfaqësues të kompanisë së kontraktuar. Nëse po monitoroni një kontratë punimesh dhe nuk mund të futeni drejtpërdrejt në vendin ku po zhvillohen punimet, mund të provoni të intervistoni banorët në zonën përreth.

Para se të vizitoni ndonjë vendndodhje ndërtimi, duhet të merrni **miratimin e klientit ose autoriteteve përkatëse**. Kjo siguron që vizita juaj të jetë e autorizuar dhe e koordinuar me menaxhimin e vendndodhjes, për të shmangur ndërprerjet dhe konfliktet e mundshme. **Gjithmonë konfirmoni datën, orën dhe personin e kontaktit para se të shkoni në vendndodhje.**

Vendndodhjet e ndërtimit mund të jenë mjedise të rrezikshme. Rreziqet përfshijnë makina në lëvizje, objekte që bien, sipërfaqe të pabarabarta dhe zona të kufizuara. Veproni me kujdes të madh në çdo kohë:

- Vishni pajisjet mbrojtëse të përshtatshme (kapele, këpucë sigurie, jelek me dukshmëri të

lartë).

- Qendroni brenda zonave të sigurta të përcaktuara dhe ndiqni të gjitha udhëzimet e vendndodhjes.
- Mos ndërhyni në punimet ose pajisjet që janë në përdorim.

Inspektimi i vendndodhjes: A ishit në gjendje të kryeni një vizitë në vendndodhje (në ndonjë nga vendndodhjet e implementimit/dorëzimit të përcaktuara në kontratë)?

Vizitat në vendndodhje shpesh kërkojnë miratim paraprak për të hyrë në ambient, veçanërisht për lokacione të sigurta ose të kufizuara (p.sh., vendndodhje ndërtimi, magazina ose objekte të kontrolluara). Në shumicën e rasteve, autoriteti kontraktor (klienti) ose kontraktori kryesor është përgjegjës për lejimin e hyrjes.

Nëse nuk keni qenë në gjendje të vizitoni vendndodhjen, ju lutemi tregoni nëse:

- *Ju është refuzuar hyrja, ose*
- *Pyetja nuk ishte e zbatueshme (p.sh., nëse kontrata përfshin vetëm shërbime ose furnizime pa vendndodhje fizike), ose*
- *Keni përdorur metoda alternative vëzhgimi, si shqyrtimi i dokumentave/fotove, intervistimi i banorëve lokalë, ose vëzhgimi nga zona publike pranë vendndodhjes.*

Inspektimi i vendit ku zhvillohen punimet: A keni pasur mundësi të vizitoni (ndonjë nga) vendet e zbatimit të kontratës që përcaktohen në kontratë?

Po
Jo

[Nëse përgjigja është "Po", ju del një pyetje tjetër që kërkon të specifikoni se cilat vende keni vizituar.] Nëse përgjigjen "Jo", nuk ju dalin pyetje të tjera]

Cilat vende të zbatimit të kontratës keni inspektuar?

Këtu mund të zgjidhni vendet që keni vizituar nga vendet që ju dalin në seksionin paraardhës. Nëse ju dhe ekipi juaj i monitorimit keni vizituar më shumë se një prej atyre vendeve/siteve, mund të përdorni butonin "Shto një sit tjetër" më poshtë. Ju lutemi, vendosni edhe datën e inspektimit.

Vendi i inspektuar

Data e inspektimit

[përzgjedhja nga vendet që ju dalin si listë në seksionin paraardhës]

+ Shto një inspektim tjetër

Përditëso listën e vendeve të inspektimit

[Nëse përgjigjeni "Jo", ju del pyetja alternative "Pse jo"]

Pse jo?

Mund të jepni këtu një ose më shumë arsye se pse ju/ekipi juaj i monitorimit nuk keni qenë në gjendje të vizitoni një prej vendeve ku zbatohet kontrata.

- Nuk u lejua hyrja në vendin e zbatimit të kontratës.
- Nuk arritëm të gjenim vendndodhjen e saktë të vendit ku zbatohet kontrata.
- Mungesë burimesh.
- Tjetër:

Nëse mund të identifikoni personin që refuzoi hyrjen, shkruani emrin, datën/orën dhe arsyen e dhënë.

Në cilën fazë të zbatimit është projekti?

- A. Nuk ka filluar (kontrata është në fuqi, por zbatimi i saj nuk ka filluar në përputhje me kalendarin e parashikuar.)
- B. Në proces zbatimi (ka filluar zbatimi i kontratës.)
- C. Përfunduar (Zbatimi i kontratës raportohet se ka përfunduar dhe kontrata rezulton e përfunduar.)

NUK KA FILLUAR: [Nëse zgjidhet opsioni A, shfaqet një tjetër pyetje lidhur me arsyet e vonesës]

Nëse keni informacion pse nuk ka filluar të zbatohet kontrata sipas planit, vendosini këtu.

NË PROCES ZBATIMI: [Nëse zgjidhni opsionin B, shfaqen pyetje të tjera, deri tek "metodat E Hetimit":]

A po zbatohet kontrata sipas kalendarit të parashikuar në kontratë?

Shikoni nëse ofrimi i mallrave/shërbimeve/punimeve të kontraktuara ka filluar sipas kalendarit të rënë dakord dhe nëse zbatimi i kontratës po ecën pa vonesa të konsiderueshme. Këto të dhëna mund të merren nga raportet e zbatimit të kontratës, vëzhgimet në vend ose intervistat me individë që mbikëqyrin procesin e zbatimit. Nëse ka pasur vonesa, përpiquni të mblidhni dhe raportoni informacione se çfarë i ka shkaktuar ato.

Po

Jo

Nëse nuk mund të përgjigjeni po ose jo, ju lutemi jepni një shpjegim

Ju lutemi, vendosni informacione më të hollësishme në fushën më poshtë. Nëse u përgjigjët "Jo", përshkruani problemet e zbuluara. Nëse nuk mund të përgjigjeni "Po" ose "Jo", ju lutemi jepni një shpjegim Jepni shpjegime sa më faktike dhe sa më të sakta.

A janë ofruar mallrat/shërbimet/punimet në sasi të dhe cilësinë e kërkuar në kontratë?

Mund të kontrolloni nëse dërgesat e dokumentuara në vend përputhen me sasi të e specifikuar në kontratë. Është gjithashtu e rëndësishme të verifikohet nëse mallrat, shërbimet ose punimet e dorëzuara plotësojnë specifikimet teknike për të cilat është rënë dakord. Për shembull, sigurohuni që fletoret e blera të përmbajnë numrin e saktë të faqeve dhe dendësinë e specifikuar të letrës, ose që kompjuterët e blerë të kenë shpejtësinë e specifikuar të procesorit. Edhe intervistat me marrësit ose përfituesit e këtyre mallrave dhe shërbimeve mund të ofrojnë informacione të vlefshme nëse sasi të e dorëzuara dhe cilësia e artikujve përmbushin pritshmëritë për përdorimin e tyre.

Nëse po monitoroni një kontratë punimesh dhe keni akses në dokumentacionin teknik, mund të vlerësoni nëse punimet e dorëzuara korrespondojnë me planet dhe specifikimet e materialeve të përdorura. Gjithashtu, mund të vëzhgoni cilësinë e përgjithshme të punimeve të dorëzuara nga pikëpamja teknike, duke parë nëse ka ndonjë mangësi apo problem të dukshëm teknik.

Në projektet e ndërtimit, mund të verifikoni nëse masat dhe pajisjet për mbrojtjen e mjedisit janë zbatuar në përputhje me projektin e miratuar dhe specifikimet teknike. Për shembull, aspekte të tilla si: kullimi i ujërave të shiut, rezervuarët mbajtës të ujit, mbjellja e bimëve/pemëve të gjelbra dhe pajisjet për mbrojtjen nga zhurma. Kur është e mundur të vëzhgoni, listoni deri në 3 elementë specifikë (p.sh. m² trotuar, 1m bordurë, m³ beton, pajisje loje për fëmijë, pemë, stolat) dhe shënoni çdo ndryshim >5% midis sasive të vëzhguara dhe atyre të paguara.

Po

Jo

Nëse nuk mund të përgjigjeni po ose jo, ju lutemi jepni një shpjegim

Ju lutemi, vendosni informacione më të hollësishme në fushën më poshtë. Nëse u përgjigjët "Jo", përshkruani problemet e zbuluara. Nëse nuk mund të përgjigjeni "Po" ose "Jo", ju lutemi jepni një shpjegim Jepni shpjegime sa më faktike dhe sa më të sakta.

--

A janë pagesat e bëra në përputhje me ecurinë e zbatimit të kontratës, sipas vëzhgimeve tuaja?

Infobox: nëse keni akses në urdhërpagesa dhe fatura, mund të kontrolloni nëse mallrat/shërbimet/punimet e dokumentuara si të dorëzuara dhe të paguara korrespondojnë me atë që keni konstatuar në vend ose me atë që është dokumentuar në raportet e zbatimit ose ecurisë. Kjo mund të jetë veçanërisht e rëndësishme në kontratat me disa faza zbatimi dhe pagesa me këste pas përfundimit të secilës fazë. Për shembull, në ndërtimin e një sheshi lojrash, mund të kontrolloni nëse të gjitha pjesët e projektit të raportuara si të zbatuara dhe të paguara janë përfunduar realisht apo jo.

Po

Jo

Nëse nuk mund të përgjigjeni po ose jo, ju lutemi jepni një shpjegim

Ju lutemi, vendosni informacione më të hollësishme në fushën më poshtë. Nëse u përgjigjët "Jo", përshkruani problemet e zbuluara. Nëse nuk mund të përgjigjeni "Po" ose "Jo", ju lutemi jepni një shpjegim Jepni shpjegime sa më faktike dhe sa më të sakta.

[shfaqet vetëm kur në seksionin paraardhës tregohen ndryshime të kontratës - duhet të plotësohen të dyja kushtet, opsioni B dhe ndryshimet e kontratës]

A janë justifikuar ndryshimet e kontratës me shkrim?

Ndryshimet e kontratës zakonisht duhet të shoqërohen me shpjegimin se pse ato ndryshime janë të domosdoshme për vazhdimin dhe përfundimin e kontratës. Mund të kontrolloni nëse dokumentacioni i marrë përfshin shpjegime të hollësishme për çdo ndryshim ekzistues të kontratës.

Nëse po monitoroni një kontratë punimesh, mund të vlerësoni edhe nëse ndryshimet e kontratës janë shpjeguar nga këndvështrimi teknik. Për shembull, mund të vlerësoni nëse ndryshimet përfshijnë shërbime që ishin qartësisht të domosdoshme dhe duhet të kishin qenë pjesë e ofertës fillestare, ose anasjelltas, nëse përfshijnë shërbime që janë të panevojshme ose jo me kosto jo të leverdishme nga këndvështrimi teknik. Në rastet kur ka ndryshime të kostove, mund të shihni gjithashtu edhe nëse çmimi i shërbimeve të përfshira përputhet me standardet e tregut. Gjithashtu, a ishin masat mjedisore për zbutjen e ndikimeve në përputhje me modifikimin e kontratës?

Po

Jo

Nëse nuk mund të përgjigjeni po ose jo, ju lutemi jepni një shpjegim

Ju lutemi, vendosni informacione më të hollësishme në fushën më poshtë. Nëse u përgjigjët "Jo", përshkruani problemet e zbuluara. Nëse nuk mund të përgjigjeni "Po" ose "Jo", ju lutemi jepni një shpjegim Jepni shpjegime sa më faktike dhe sa më të sakta.

Kur është e mundur, a **përputhen ndryshimet e vëzhguara në vendndodhje** me modifikimet e nënshkruara dhe të çmuara (urdhrat e ndryshimeve) të miratuara nga blerësi?

Po

Jo

Nëse nuk mund të përgjigjeni po ose jo, ju lutemi jepni një shpjegim

Ju lutemi, vendosni informacione më të hollësishme në fushën më poshtë. Nëse u përgjigjët "Jo", përshkruani problemet e zbuluara. Nëse nuk mund të përgjigjeni "Po" ose "Jo", ju lutemi jepni një shpjegim Jepni shpjegime sa më faktike dhe sa më të sakta.

A po përmbushen parashikimet e tjera të kontratës?

Kontratat publike kanë dispozita të tjera specifike për t'u zbatuar si duhet. Ja disa pika që duhen kontrolluar gjatë monitorimit të tyre:

- A po ofrohen mallrat/shërbimet/punimet vetëm nga kompania e kontraktuar dhe nënkontraktorët e saj të specifikuar në kontratë? Kjo mund të verifikohet duke ekzaminuar dokumentacionin, duke identifikuar pajisjet në vend, duke kontrolluar uniformat e punëtorëve dhe duke intervistuar individë në vend dhe banorë në afërsi të zonës ku po zbatohet kontrata. Nëse ka prova të nënkontraktimit joformal ose nënkontraktimeve të tjera të paparashikuara në kontratë, jepni një përshkrim dhe përmendni se cilat kompani të tjera duket se janë të përfshira në ekzekutimin e kontratës.

- A po mbikëqyrret kontrata nga mbikëqyrësi i kontratës që ka caktuar autoriteti kontraktues? Mund të kontrolloni nëse dokumentet e zbatimit të kontratës (si urdhërpagesat dhe raportet e ecurisë) janë nënshkruar prej tyre (mbikëqyrësve) ose të pyesni njerëzit në vendin e zbatimit të kontratës nëse aty vjen rregullisht mbikëqyrësi i kontratës nga autoriteti kontraktues. Kini parasysh se, në projekte të mëdha infrastrukturore, mbikëqyrësi i punimeve mund të jetë një kompani, e përzgjedhur nëpërmjet një procedure prokurimi më vete. Ekipi i mbikëqyrjes mund të përfshijë gjithashtu mbikëqyrës mjedisorë që monitorojnë planet e zbatjes së ndikimeve mjedisore. A është kjo e zbatueshme sipas kontratës?

- Nëse janë futur kriteret e dhënies së kontratës që lidhen me prokurimin e gjelbër, a është monitoruar përmbushja e këtyre kriterëve gjatë zbatimit të kontratës?

- Nëse kompania e kontraktuar ka shkëlur ndonjë parashikim të kontratës, a është vënë ndonjë gjobë siç parashikohet në kontratë? Mund të shqyrtoni dokumentet e zbatimit të kontratës për

të parë nëse ka të dhëna për ndonjë paralajmërim me shkrim apo për ndonjë gjobë të vënë.

Po

Jo

Nëse nuk mund të përgjigjeni po ose jo, ju lutemi jepni një shpjegim

Ju lutemi, vendosni informacione më të hollësishme në fushën më poshtë. Nëse u përgjigjët "Jo", përshkruani problemet e zbuluara. Nëse nuk mund të përgjigjeni "Po" ose "Jo", ju lutemi jepni një shpjegim Jepni shpjegime sa më faktike dhe sa më të sakta.

Kur është e mundur të vëzhgoni, a përputhen identifikuesit e kompanive në vendndodhje (etiketat e pajisjeve, logot në pajisjet mbrojtëse, furgonët) me furnitorët/nënkontraktorët e listuar në kontratë?

Po

Jo

Nëse nuk mund të përgjigjeni po ose jo, ju lutemi jepni një shpjegim

Ju lutemi, vendosni informacione më të hollësishme në fushën më poshtë. Nëse u përgjigjët "Jo", përshkruani problemet e zbuluara. Nëse nuk mund të përgjigjeni "Po" ose "Jo", ju lutemi jepni një shpjegim Jepni shpjegime sa më faktike dhe sa më të sakta.

[Nëse është zgjedhur jo:]

Ju lutemi, listoni identifikuesit e vëzhguar:

PËRFUNDUAR: [Nëse zgjidhni opsionin C, shfaqen pyetje të tjera, deri tek "metodat E Hetimit":]

A i ka dorëzuar kompania e kontraktuar plotësisht mallrat/shërbimet/punët e dakordësuara siç përcaktohet

në kontratë?

Këtu, mund të raportoni nëse zbatimi siç vërehet në terren përputhet me certifikatat e përfundimit ose nëse është i paplotë. Nëse po monitoroni një kontratë punimesh, kontrolloni nëse autoriteti kontraktues e ka inspektuar si duhet projektin e përfunduar. Mund të flisni edhe me marrësit ose përfituesit e mallrave ose shërbimeve dhe të zbuloni nëse ata kanë ndonjë ankesë në lidhje me realizimin e pjesëshëm të kontratës.

Po

Jo

Nëse nuk mund të përgjigjeni po ose jo, ju lutemi jepni një shpjegim

Ju lutemi, vendosni informacione më të hollësishme në fushën më poshtë. Nëse u përgjigjët "Jo", përshkruani problemet e zbuluara. Nëse nuk mund të përgjigjeni "Po" ose "Jo", ju lutemi jepni një shpjegim Jepni shpjegime sa më faktike dhe sa më të sakta.

A vazhduan të ishin mallrat/punimet e dorëzuara në një gjendje të pranueshme pas përfundimit të kontratës?

Nëse zbatimi i kontratës që keni zgjedhur të monitoroni ishte i plotë në kohën e monitorimit, mund të shihni edhe gjendjen e mallrave dhe punimeve të përfunduara kur të vizitoni vendin ku është zbatuar kontrata. Disa probleme që mund të konstatohen (p.sh. zbehja e bojës së murit, plasaritjet e mureve, instalime jo të mira pajisjesh) direkt disa muaj pas përfundimit mund të jenë tregues të një zbatimi jo të duhur të kontratës dhe ia vlejnjë të raportohen.

Po

Jo

Nëse nuk mund të përgjigjeni po ose jo, ju lutemi jepni një shpjegim

Ju lutemi, vendosni informacione më të hollësishme në fushën më poshtë. Nëse u përgjigjët "Jo", përshkruani problemet e zbuluara. Nëse nuk mund të përgjigjeni "Po" ose "Jo", ju lutemi jepni një shpjegim Jepni shpjegime sa më faktike dhe sa më të sakta.

A po përdoren mallrat e prokuruar për qëllimin e synuar dhe nga përfituesit e synuar?

Po

Jo

Nëse nuk mund të përgjigjeni po ose jo, ju lutemi jepni një shpjegim

Ju lutemi, vendosni informacione më të hollësishme në fushën më poshtë. Nëse u përgjigjët "Jo", përshkruani problemet e zbuluara. Nëse nuk mund të përgjigjeni "Po" ose "Jo", ju lutemi jepni një shpjegim Jepni shpjegime sa më faktike dhe sa më të sakta.

Në rastin e një kontrate punimesh, a është projekti i plotë dhe plotësisht funksional?

Po

Jo

Nëse nuk mund të përgjigjeni po ose jo, ju lutemi jepni një shpjegim

Ju lutemi, vendosni informacione më të hollësishme në fushën më poshtë. Nëse u përgjigjët "Jo", përshkruani problemet e zbuluara. Nëse nuk mund të përgjigjeni "Po" ose "Jo", ju lutemi jepni një shpjegim Jepni shpjegime sa më faktike dhe sa më të sakta.

Informacione të tjera të rëndësishme

Metodat e hetimit

Burime

[mund të zgjidhet më shumë se një burim]

Kërkimi në Web

Kërkesë për dokumentacion

Inspektimi i vendit të zbatimit të kontratës

Intervistë / takim me përfaqësues të autoritetit kontraktues

Intervistë / takim me mbikëqyrësin e kontratës

Intervistë / takim me personat përgjegjës për zbatimin e kontratës

Intervistë / takim me përfituesit fundorë të mallrave/shërbimeve/punimeve të kontraktuara

Intervistë / takim me persona të tjerë (p. sh. banorë të zonës)

Tjetër:

Në rastin e burimeve në internet, cilat burime keni përdorur?

Kë intervistuat? Këtu mund të vendosni emrat dhe rolet e tyre.

<i>Emri</i>	<i>Roli</i>

+ Shto të intervistuar tjetër

A keni pasur mundësi të përdorni të gjithë dokumentacionin kryesor për monitorimin?

	Po	Jo
Kontrata	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Zgjatjet dhe ndryshimet e kontratës (nëse ka)	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Raportet për zbatimin e kontratës	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Urdhër pagesat dhe faturat	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Për projektet e ndërtimit, dokumentet teknike (p. sh. projektet, specifikimet e materialeve të përdorura), dhe raportet e ecurisë së projekteve.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Raporti i vlerësimit të ofertave	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

Nëse nuk mundët ta aksesoni të gjithë dokumentacionin, ju lutemi tregoni pengesat me të cilat u përballët. Komente të tjera

- Dokumentacioni ishte i paplotë
- Dokumentacioni nuk u mor në kohë
- Kërkesa për akses nuk u miratua
- Tjetër:

Ju lutemi, vendosni informacione më të hollësishme në fushën më poshtë. Jepni shpjegime sa më faktike dhe sa më të sakta.

Ngarkimi i skedarit (Hapi 1: kontrata, kontrata zgjatja, dokumente, fotografim i ekranit/screenshots me informacionin e kompanisë së kontraktuar/ nënkontraktorit; Hapi 2: fotografi, video)

Ngarkoni këtu dokumentacionin dhe informacione të tjera që keni mundur të grumbulloni nga analiza e dokumentacionit dhe vizitat në terren.

Nëse dëshironi, mund të shtoni një përmbledhje të shkurtër të skedarit përkatës dhe çfarë tregon [p.sh. Kontrata, Zgjatja e Kontratës, Fotografi e ..., Video e...].

Nëse keni më shumë se një skedar, përdorni butonin "Shto skedar tjetër" më poshtë.

! Madhësia maksimale e dokumentit për ngarkim: 8 mb

[emri i skedarit]

[përshkrimi]

+ Shto skedar tjetër

Si lidhet gjithçka: përmbledhje përfundimtare

Në këtë përgjigje, do të donim të lexonim një përmbledhje përfundimtare të monitorimit tuaj. Na tregoni historinë e asaj çka patë, lexuat dhe dëgjuat. Kjo përmbajtje do të raportohet më pas në krye të raportit, si një abstrakt për të paraqitur punën tuaj dhe mund të jetë një mjet i dobishëm për t'i shpërndarë gjetjet tuaja në komunitetin tuaj, përmes mediave, kontakteve me gazetarët, për paraqitjen e raportit tuaj përpara një autoriteti kombëtar nëse janë zbuluar parregullsi, ose për ta ndarë me monitorues të tjerë. Jini sa më precizë dhe objektivë; përmbledhja duhet të bazohet në të dhënat e mbledhura gjatë gjithë procesit të monitorimit. Mos bëni deklaratë që nuk mund të vërtetohen me të dhënat e marra, të cilat duhet të jenë pjesë e raportit. Përdorni një gjuhë të respektueshme, të qartë dhe koncize.

- **Ky raport është gati për shqyrtim**
Ky raport tani është i mbyllur dhe nuk mund të bëhen ndryshime të tjera nga monitoruesit. Tashmë raporti i kalon Ekipit Redaktues.
- **Ruaj**

HAPI 3 - REZULTATET DHE NDIKIMI I PROJEKTIT

Ky seksion synon të jetë një mjet për të nxitur reflektimin e monitoruesve që ata të japin këndvështrimin e tyre të bazuar në procesin e monitorimit. Kontributi juaj në këtë seksion do të sjellë vlerë të rëndësishme për metodologjinë iMonitor dhe do të kontribuojë në përmirësimin e saj.

Ky hap i fundit përqendrohet tek analizimi, mësimet e nxjerra dhe ndikimi që perceptohet të ketë ky aktivitet nga këndvështrimi juaj. Ky proces ka për qëllim krijimin e dialogut dhe ndërgjegjësimin. Edhe gjetjet e vogla mund të sjellin debat të rëndësishëm për integritetin në prokurimin publik si dhe për të rritur ndërgjegjësimin dhe për të mbështetur vizibilitetin e monitorimit qytetar.

Jeni të inkurajuar:

- *Të ndani hapur përshtypjet tuaja, edhe nëse rezultatet e arritura gjatë procesit të monitorimit mund të mos kenë qenë "mbresëlënëse" dhe nëse nuk keni konstatuar ndonjë parregullsi në kontratë. Çdo vëzhgim është i vlefshëm dhe kontribuon në ndërtimin e një tabloje realiste të situatës.*
- *Mendoni pak edhe se si mund të shpërndahen rezultatet e procesit të monitorimit dhe/ose një version anonim i raportit dhe nëse planifikoni që ta shpërndani.*

Autoritetet publike

Nëse ky raport i është dërguar një autoriteti publik antikorrupsion, a ka reaguar ai ndaj raportit juaj?

- Po, ka reaguar në lidhje me raportin
- Autoriteti ka marrë masa (p. sh. ka ndërmarrë një hetim ose hapa të tjerë)
- Jo

Lidhje të reja që keni krijuar

Si i keni shpërndarë apo po i shpërndani rezultatet e monitorimit tuaj qytetar?

- X/Twitter
- Facebook
- Instagram
- Aktivitete lokale
- blog/website i ekipit/organizatës
- Fletushka ose metoda të tjera offline (jo në internet)

- Kërkesa për dëgjesa ose takime private
Intervista në Media
 Tjetër:

Me kë keni krijuar lidhje për të diskutuar rezultatet e monitorimit tuaj?

<i>Personi</i>	<i>Roli</i>	<i>Organizataa</i>	<i>Lloji i lidhjes</i>
			[menuja e përzgjedhjes]

+ Shto subjekt

A ka folur media për monitorimin tuaj?

- Po
Jo

[Nëse po, shfaqet një pyetje tjetër]

Rezultatet e monitorimit janë transmetuar në media:

- TV lokale
 TV kombëtare
 Gazetat lokale
 Gazetat kombëtare
 Blog ose media të tjera në internet
 Tjetër:

A keni pasur kontakte me administratën publike (me Kryetarin e Bashkisë ose personelin ekzekutiv) për të prezantuar ose diskutuar me ta rezultatet tuaja të monitorimit?

- Po
Jo

[Nëse po, shfaqet një pyetje tjetër]

A u është përgjigjur administrata publike kërkesave tuaja apo problemeve që keni ngritur?

- Asnjë përgjigje
- Disa janë përgjigjur, të tjerët jo
- Na dhanë përgjigje formale ose të përgjithshme
- Të paktën njëri nga të kontaktuarit na dha përgjigje konkrete
- I zbatuan rekomandimet tona dhe tani projekti po ecën mirë ose është më efikas
- Ne raportuam një problem që tani është zgjidhur
- Tjetër:

Përshkruajeni rastin. Cilat fakte ose ngjarje ju bëjnë të besoni se monitorimi juaj qytetar kishte (ose nuk kishte) ndikim në organizatat e përfshira në kontratën që keni monitoruar?

- **Ky raport është gati për shqyrtim**
Ky raport tani është i mbyllur dhe nuk mund të bëhen ndryshime të tjera nga monitoruesit. Tashmë raporti i kalon Ekipit Redaktues.
- **Rua**

REFERENCAT

Enachi, Diana and Pîrvan, Viorel (2022). *Monitoring Public Procurement Guide: A Tool For Civil Society*. Institute for Development and Social Initiatives (IDIS) "Viitorul". https://www.ptfund.org/wp-content/uploads/2018/07/Monitoring-Guide_EN-web.pdf

Transparency International USA (2012). *Procurement monitoring guide: A Tool for Civil Society*. <https://knowledgehub.transparency.org/assets/uploads/topic-guides/Procurement-Monitoring-Guide-Final-Interactive-PDF.pdf>

Transparência Brasil (2019). *Checklists para controle social de obras públicas*. <https://www.transparencia.org.br/downloads/publicacoes/Checklists%20controle%20social.pdf>

Oficina Antifrau de Catalunya (2018). *Guía para la integridad en la contratación pública*. <https://guies.antifrau.cat/es/guia-integritat-contractacio>

